



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.7.2023

Nr: 699

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË RROGOZHINË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT "BASHKË FITOJMË", ZJ. LIJE NAZIM DEDEJ

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr.2375 prot., datë 04.7.2023, Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Sadete Asllan Kaja, propozuar nga subjekti politik Koalicioni "Bashkë Fitojmë".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit Bashkë Fitojmë, për Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 6, zj. Lije Nazim Dedej.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Koalicionit Bashkë Fitojmë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 16049 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Data: 12.7.2023 Nr: 699
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit "Bashkë Fitojmë", zj. Lije Nazim Dedej".

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Lije Nazim Dedej, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Lije Nazim Dedej.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Lije Nazim Dedej, në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Lije Nazim Dedej, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Lije Nazim Dedej, në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, me kandidatin nga lista shumemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Lije Nazim Dedej.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI